

Në vijim të aktiviteteve për zbatim të Masave të Eficiencës së Energjisë në Sektorin Rezidencial, duke filluar me ndërtesat shumë banesore të banimit social dhe pastaj shtëpitë individuale, ju njoftojmë se Fondi i Kosovës për Eficiencë të Energjisë (FKEE) ka shpallur procedurën e konkurrimit për plotësimin e disa pozitave të Njesisë Implementuese të Projektit (NjIP) që do të krijohet.

Ky projekt që realizohet nga FKEE financohet nga Komisioni Evropian përmes marrëveshjes IPA III të nënshkruar në mes të Komisionit Evropian dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Shërbimet profesionale të kërkuara si pozita individuale të konsulentëve apo specialistëve që do të plotësohen përmes këtij procesi konkurrues janë paraqitur në vijim:

1. Udhëheqës i Njesisë Implementuese të Projektit (NjIP)
2. Konsulent/Specialist për Shërbime të Prokurimit
3. Konsulent/Specialist për Marrëdhënie me Publikun
4. Konsulent/Specialist për Financa

Pozitat e mësipërme do të angazhohen me kontratë për shërbime konsulente, me orar të plotë, me qëllim implementimin e projektit të lartshënuar, me një afat prej 1 viti, me mundësi vazhdimi.

FKEE njofton të gjithë të interesuarit për hapjen e kësaj mundësie të angazhimit, dhe fton të gjithë ata që plotësojnë kushtet të aplikojnë për t'u bërë pjesë e NjIP në FKEE. Pozitat e hapura për kontraktim përmes sistemit të Prokurimit Publik të KRPP 'e-Prokurimi' i gjeni në këtë link [http://e-prokurimi.rks.gov.net/SPIN\\_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=2418113](http://e-prokurimi.rks.gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=2418113) përmes të cilit edhe realizohet aplikimi, si mënyrë e vetme.

Për çdo paqartësi, ju lutem na kontaktoni duke përdorur detajet e mëposhtme të kontaktit:

Email: [info@fkee-rks.net](mailto:info@fkee-rks.net)  
Tel: +383 (0) 38 223 777